



|   |                               |                               |                               |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Prilmenj/Prodato<br>Received/Delivery | 17.11.2022                    | 2 vitri<br>god<br>year        |                               |
| Organ /Njësia<br>Organ /Jedinitca<br>Org./Unit              | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKPM/SHCR   | 7201/2022                     |                               | 114                           |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.883/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.883/2022 të datës 10.10.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 në paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.11.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet** ankesa me numër A.nr.883/2022 e datës 10.10.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted] **si e bazuar.**

**II. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore-administrative për harmonizimin e koeficientit të pagës së ankueses nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7).

**III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesja [redacted] e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 10.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5993/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë me

Nr. 4596-2/22 të datës 20.09.2022 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 11.10.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa, Këshilli më datë 20.10.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë të shqyrtimit dhe vendosjes.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 5993/2022 të datës 10.10.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.332<sup>(1)</sup> të datës 20.10.2008; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.332<sup>(2)</sup> të datës 20.10.2010; Vendimin me numër protokoll 1214/11 të datës 24.06.2011 për transferimin e ankueses; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr. 332<sup>(3)</sup> të datës 24.06.2011; Akt Emërimit të datës 24.06.2014; Vendimin me numër protokoll 4705/19 të datës 23.07.2019 për transferimin e përhershëm të ankueses; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 29.08.2019; Kërkesën për ngritjen e koeficientit të datës 16.08.2022 nga ankuesja; Përgjigjen në kërkesë me Nr. 4596-2/22 të datës 20.09.2022 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Konkursin e datës 27.11.2018 të shpallur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për Zyrtar i të Hyrave Financiare; Konkursin e datës 29.12.2018 të shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për pozitën Zyrtar i të Hyrave Financiare; Kërkesën për koeficient ekuivalent me pozitën e punës të datës 19.10.2020 nga ankuesja; Kërkesën për ngritjen e koeficientit të datës 05.11.2015 dhe 13.11.2014 nga ankuesja; Kërkesën për avancim dhe ngritje të koeficientit të datës 13.03.2014 nga ankuesja; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.10.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 20.10.2022; Emailin e datës 17.10.2022 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 13.10.2022 nga [redacted] për [redacted]

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rezulton se ankuesja është punësuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapë, rrjedhimisht e njëjta sipas Akt Emërimit në fuqi të datës 29.08.2021 është e emëruar me transferim të përhershëm në pozitën e punës me titull "Zyrtare e të Hyrave" në Divizionin për Buxhet dhe Financa, me koeficient gjashtë (6) të pagës.

Po nga shqyrtimi shkresave të lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesja më datë 19.10.2020 ka parashtruar kërkesë të Zyrtari me i Lartë Administrativ për harmonizim të koeficient të pagës për pozitën Zyrtare e të Hyrave, e për të cilën kërkesë ankuesja nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje. Ankuesja serish më datë 16.08.2022 ka parashtruar kërkesë për ngritjen e koeficientit për harmonizim të koeficienti lidhur me pozitën e punës Zyrtare e të Hyrave, ndërsa, përmes përgjigjes të datës 20.09.2022, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor ka njoftuar të njëjtën se për ngritje të koeficientit duhet të ketë mjete buxhetore të planifikuara në programe përkatëse.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti njihet e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës sipas pozitës që



mban në raport me pozitat e njëjta si rast në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Në funksion të shqyrtimit të bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ju referua Nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar së: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, si dhe nenit 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht konstatoj së e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës duhet të realizojnë pagë të njëjtë.

Po ashtu nga provat e ofruara nga pala ankuese Kolegji ka gjetur së sipas konkurseve të shpallura nga organet e administratës qendrore lidhur me pozitën Zyrtar i të Hyrave Financiare është përcaktuar koeficient shtatë (7) i pagës. Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del së Ministria e Tregtisë dhe Industrisë më datë 27.11.2018 ka shpallur konkursin për pozitën Zyrtar i të Hyrave Financiare me koeficient shtatë (7), ndërsa Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural më datë 29.12.2018 ka shpallur konkursin për pozitën Zyrtar i të Hyrave Financiare me koeficient shtatë (7), e mbi këto fakte rrjedhë së ankuesi për pozitë të njëjtë të punës realizon koeficient 6 të pagës pra koeficient jo të njëjtë të pagës me nëpunësit të cilët ushtrojnë pozitë të njëjtë të punës.

Andaj, në vlerësimin e Kolegjit mos realizmi i pagës së njëjtë për punë të njëjtë paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të ankuesit kundrejt zyrtareve tjerë në institucionet ministrore e që ushtrojnë detyra të njëjta apo të ngjashme të punës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe se trajtimi jo i barabartë i zyrtareve publikë në kuptim të së drejtës së pagës është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: "1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..."* Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm. Kështu që bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuseses për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Siç u theksua me sipër, organi i punësimit konkretisht Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është i obliguar që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme juridike-administrative lidhur me harmonizimin e koeficientit të ankuseses ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.883/2022

Ilire Mehmeti

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

